



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 232

Tiranë – E enjte, 28 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 110/2017 datë 14.12.2017	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 6.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar”..... 12227
Ligj nr. 112/2017 datë 14.12.2017	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinjtë e Tavolinës, 2015..... 12227
Ligj nr. 113/2017 datë 14.12.2017	Për ratifikimin e dokumenteve ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale, ratifikuar me ligjin nr. 84/2012..... 12243
Ligj nr. 114/2017 datë 18.12.2017	Për disa shtesa në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin” 12245
Ligj nr. 115/2017 datë 18.12.2017	Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës..... 12246



LIGJ
Nr. 110/2017

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË
6.11.2017, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME
DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 130/2016,
“PËR BUXHETIN E VITIT 2017”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 6.11.2017, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar”.

Miraturar në datën 14.12.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10701, datë
26.12.2017, të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Ilir Meta**

LIGJ
Nr. 112/2017

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN
NDËRKOMBËTARE PËR VAJIN E
ULLIRIT DHE ULLINJTË E
TAVOLINËS, 2015**

Në mbështetje të neneve 78,83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen ndërkombëtare për vajin e ullirit dhe ullinjtë e tavolinës, 2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ligji nr. 10028, datë 11.12.2008, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërkombëtare për ullirin dhe vajin e ullirit”, shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.12.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10703, datë 26.12.2017
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Ilir Meta**

**MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE
PËR VAJIN E ULLIRIT DHE ULLINJTË E
TAVOLINËS, 2015**

KAPITULLI I
OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Neni 1

Objektivat e Marrëveshjes

- Në lidhje me standardizimin dhe kërkimin:
 - Të synojë të arrijë uniformitet në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar në lidhje me karakteristikat fiziko-kimike dhe organoleptike të vajrave të ullirit, vajrave të bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës, me qëllim parandalimin e ndonjë pengese ndaj tregtisë.
 - Të kryejë aktivitete në fushën e testimit fiziko-kimik dhe organoleptik, me qëllim zgjerimin e njohurive për përbërjen dhe karakteristikat e cilësisë së produkteve të ullirit, me synim konsolidimin e standardeve ndërkombëtare dhe në këtë mënyrë për të mundësuar:
 - Kontrollin e cilësisë së produktit;
 - Tregtinë ndërkombëtare dhe zhvillimin e saj;
 - Mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit;
 - Parandalimin e praktikave mashtruese dhe çorientuese dhe falsifikimit.
 - Të forcojë rolin e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit si një forum i ekselencës për komunitetin shkencor ndërkombëtar në fushën e ullinjve dhe vajit të ullirit;
 - Të koordinojë studimet dhe kërkimin për cilësitë ushqyese dhe karakteristika të tjera të



brendshme të vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës;
- Të lehtësojë shkëmbimin e informacionit për flukset ndërkombëtare të tregtisë.

2. Në lidhje me kultivimin e ullirit, teknologjinë e vajit të ullirit dhe bashkëpunimin teknik:

- Të nxisë bashkëpunimin teknik dhe kërkimin dhe zhvillimin në sektorin e ullirit, duke inkurajuar bashkëpunimin e organeve dhe/ose subjekteve publike ose private, qoftë kombëtare ose ndërkombëtare;

- Të kryejë aktivitete për identifikimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e burimeve gjenetike të pemëve të ullirit;

- Të studiojë ndërveprimin midis kultivimit të ullirit dhe mjedisit, veçanërisht me synim nxitjen e konservimit mjedisor dhe prodhimit të qëndrueshëm, dhe për të garantuar zhvillimin e integruar dhe të qëndrueshëm të sektorit;

- Të nxisë transferimin e teknologjisë nëpërmjet aktiviteteve trajnuese në fushat e lidhura me sektorin e ullirit, duke organizuar aktivitete kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare;

- Të nxisë mbrojtjen e të dhënave gjeografike të produkteve të ullirit në përputhje me marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare në të cilat një anëtar mund të jetë palë;

- Të nxisë shkëmbimin e informacionit dhe përvojës në fushën fitosanitare për kultivimin e ullirit.

3. Në lidhje me promovimin e produkteve të ullirit, shpërndarjen e informacionit dhe ekonominë e ullirit:

- Të përmirësojë rolin e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit si një qendër botërore dokumentacioni dhe informacioni për pemën e ullirit dhe produktet e tij dhe si një pikë takimi për të gjithë operatorët në sektor;

- Të promovojë konsumin e produkteve të ullirit, zgjerimin e tregtisë ndërkombëtare të vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës dhe informacionin në lidhje me standardet tregtare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit;

- Të mbështesë aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare që nxisin shpërndarjen e informacionit të përgjithshëm shkencor për veçoritë ushqyese, shëndetësore dhe të tjera të vajit të ullirit dhe ullinjve të tavolinës, me synim përmirësimin e informacionit të konsumatorit;

- Të shqyrtojë balancat botërore për vajin e ullirit, vajrat e pulpës së ullirit dhe ullinjte e

tavolinës, të ndërmarrë studime dhe të propozojë masa të përshtatshme;

- Të shpërndajë të dhëna ekonomike dhe analiza për vajin e ullirit dhe ullinjte e tavolinës dhe të ofrojë anëtare me treguesit e nevojshëm për të kontribuar në funksionimin normal të tregjeve të produkteve të ullirit;

- Të shpërndajë dhe përdorë rezultatet e programeve të kërkimit dhe zhvillimit të lidhura me kultivimin e ullirit dhe studimin e zbatueshmërisë së tyre në rritjen e eficiencës së prodhimit.

KAPITULLI II PËRKUFIZIMET

Neni 2

Përkufizimet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje

1. “Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit” nënkupton organizatën ndërkombëtare të referuar në nenin 3, paragrafi 1, i krijuar për qëllimin e zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

2. “Këshilli i Anëtarëve” nënkupton organin vendimmarrës të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

3. “Palë Kontraktuese” nënkupton një Shtet, një Vëzhgues të Përhershëm në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Bashkimin Evropian ose një organizatë ndërqeveritare, siç parashikohet në nenin 4, paragrafi 3, e cila ka rënë dakord të ketë detyrim ligjor sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. “Anëtar” nënkupton një Palë Kontraktuese siç përcaktohet më lart.

5. “Vaj ulliri” nënkupton vajin e marrë vetëm nga fruti i pemës së ullirit (*Olea europaea L.*), me përjashtim të vajit të marrë me procese me tretës apo riesterifikim dhe ndonjë përzierje me vajra të llojeve të tjera. Ai përfshin llojet e mëposhtme: vaj ulliri ekstra i virgjër, vaj ulliri i virgjër, vaj ulliri i virgjër i zakonshëm, vaj ulliri i virgjër lampante, vaj ulliri i rafinuar dhe vaj ulliri i përbërë nga vaj ulliri i rafinuar dhe vajra ulliri të virgjër.

6. “Vaj i bërsisë së ullirit” nënkupton vajin e përftuar nga trajtimi i bërsisë së ullirit me tretës ose trajtime të tjera fizike, me përjashtim të vajrave të përfuara nga proceset e riesterifikimit dhe të ndonjë përzierjeje me vajra të llojeve të tjera. Ai përfshin llojet e mëposhtme: vaj i papërpunuar i bërsisë së ullirit, vaj i përpunuar i bërsisë së ullirit dhe vaj i bërsisë së ullirit i përbërë nga vaj i



përpunuar i bërsisë së ullirit dhe vajra ulliri të virgjër.

7. “Ullinj tavoline” nënkupton produktin e përgatitur nga frutat e shëndetshme të varieteteve të pemës së kultivuar të ullirit, të cilat janë zgjedhur për prodhimin e tyre të ullinjve veçanërisht të përshtatshme për konservim, dhe që janë të trajtuara në mënyrë të përshtatshme apo të përpunuar dhe të ofruar për tregti dhe për konsum përfundimtar.

8. “Produkte ulliri” nënkupton të gjitha produktet e ngrënshme të ullirit, në mënyrë të veçantë vajrat e ullirit, vajrat e bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës.

9. “Nënprodukte të ullirit” nënkupton në veçanti produktet që nxirren nga krasitja e ullirit dhe industria e produkteve të ullirit dhe produktet që rrjedhin nga përdorimet alternative të produkteve të sektorit.

10. “Vit prodhimi ulliri” nënkupton periudhën nga 1 shtatori i vitit n deri më 31 gusht të vitit $n + 1$ për ullinjtë e tavolinës dhe periudhën nga 1 tetori i vitit n deri më 30 shtator të vitit $n + 1$ për vajin e ullirit. Për hemisferën jugore, kjo periudhë korrespondon me vitin kalendarik n për ullinjtë e tavolinës dhe vajin e ullirit.

11. “Standarde tregtare” nënkupton standardet e miratuara nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, që vepron nëpërmjet Këshillit të tij të Anëtarëve, që zbatohen për vajrat e ullirit, vajrat e bërsisë së ullirit dhe ullinjtë e tavolinës.

KAPITULLI III

DISPOZITA INSTITUCIONALE

Seksioni 1

Krijimi, organet, funksionet, privilegjet dhe imunitetet

Neni 3

Struktura dhe selia e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të përmbushë funksionet e tij nëpërmjet organeve të mëposhtme:

- Këshilli i Anëtarëve;
- Kryetari dhe nënkryetari;
- Komiteti i Çështjeve Financiare dhe Administrative dhe komiteteve dhe nënkomiteteve të tjera;

d) Sekretariati Ekzekutiv.

2. Selia e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit do të vendoset në Madrid, Spanjë, për kohëzgjatjen e kësaj Marrëveshjeje, nëse Këshilli i Anëtarëve nuk vendos ndryshe.

Neni 4

Anëtarët në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit

1. Secila Palë Kontraktuese që aderon do të jetë anëtare e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit ku ka pranuar t'i nënshtrohet detyrimit ligjor sipas kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo Anëtar kontribuon ndaj objektivave të përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

3. Në këtë Marrëveshje, termi “Qeveri” interpretohet se përfshin përfaqësuesin e ndonjë shteti, një Vëzhgues të Përhershëm në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, Bashkimin Evropian dhe çdo organizatë ndërqeveritare që ka përgjegjësi të ngjashme për sa i përket negociimit, nënshkrimit, lidhjes, ratifikimit dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, në veçanti marrëveshjet për produktet.

Neni 5

Privilegjet dhe imunitetet

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit ka personalitet juridik. Në veçanti ai ka cilësinë për të kontraktuar, blerë dhe disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të fillojë procedime ligjore. Ai nuk do të ketë fuqinë e huamarrjes së parave.

2. Statusi, privilegjet dhe imunitetet e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, si dhe të Drejtorit të tij Ekzekutiv, të zyrtarëve të nivelit lartë dhe stafit dhe të ekspertëve dhe përfaqësuesve të anëtarëve që ndodhen në territorin e qeverisë pritëse për përmbushjen e funksioneve të tyre do të rregullohen nga marrëveshja e selisë e lidhur ndërmjet qeverisë pritëse dhe Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

3. Qeveria e Shtetit në të cilin është vendosur selia e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, në masën që e lejon legjislacioni i këtij shteti, përjashton shpërblimin e paguar nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit për punonjësit e tij dhe sendet pasurore, të ardhurat dhe pasuri tjetër të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit nga taksimi.



4. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të lidhë me një apo më shumë anëtarë marrëveshje për privilegje dhe imunitete të tilla që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e duhur të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Përbërja e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit përbëhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

2. Çdo anëtar cakton përfaqësuesin e tij në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit.

Neni 7

Kompetencat dhe funksionet e organeve

1. Këshilli i Anëtarëve

a) Këshilli i Anëtarëve përbëhet nga një përfaqësues për anëtar. Përveç kësaj, secili anëtar mund të caktojë një ose më shumë përfaqësues dhe një ose më shumë këshilltarë për përfaqësuesin e tij.

Këshilli i Anëtarëve është autoriteti më i lartë dhe organi vendimmarrës i Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe ushtron të gjitha kompetencat dhe funksionet që janë të nevojshme për arritjen e objektivave të kësaj Marrëveshjeje.

b) Këshilli i Anëtarëve është përgjegjës për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje. Për ta bërë këtë, ai merr vendime dhe miraton rekomandimet, me kusht që kompetencat ose funksionet përkatëse të mos i atribuohen shprehimisht Drejtorit Ekzekutiv.

Çdo vendim ose rekomandim i miratuar në përputhje me Marrëveshjen Ndërkombëtare pararendëse të kësaj Marrëveshjeje dhe që është ende në fuqi në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, do të vazhdojë të zbatohet nëse nuk është në kundërshtim me këtë Marrëveshje ose nëse nuk shfuqizohet nga Këshilli i Anëtarëve.

c) Me qëllim zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Këshilli i Anëtarëve, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, miraton:

- i) Rregullat e procedurës;
- ii) Një rregullore financiare;
- iii) Rregulloret e personelit, duke pasur parasysh ato që zbatohen për zyrtarët e organizatave të ngjashme ndërqeveritare;
- iv) Një organigramë dhe përshkrime pune;

v) Procedura të tjera të kërkuara për funksionimin e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

d) Këshilli i Anëtarëve miraton dhe publikon një raport vjetor për aktivitetet e tij dhe për funksionimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të atyre raporteve, studimeve dhe dokumenteve të tjera që i çmon të dobishme dhe të nevojshme.

2. Kryetari dhe nënkryetari

a) Këshilli i Anëtarëve emëron një kryetar dhe nënkryetar për një periudhë njëvjeçare nga radhët e delegacioneve të anëtarëve. Në rast se kryetari ose nënkryetari është kryetar i delegacionit kur kryeson mbledhjet, e drejta e tij/e saj e pjesëmarrjes në vendimet e Këshillit të Anëtarëve do të ushtrohet nga një anëtar tjetër i delegacionit të tij/të saj.

b) Pa cenuar kompetencat ose funksionet e atribuara Drejtorit Ekzekutiv, në këtë Marrëveshje ose në përputhje me këtë Marrëveshje, Kryetari do të drejtojë sesionet e Këshillit të Anëtarëve, drejtojë diskutime me synim lehtësimin e procesit vendimmarrës dhe ushtrojë përgjegjësi dhe funksione të tjera përkatëse të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe/ose të përcaktuara më tej në Rregullat e Procedurës.

c) Kryetari është përgjegjës ndaj Këshillit të Anëtarëve në ushtrimin e funksioneve të tij/të saj.

d) Nënkryetari zëvendëson kryetarin në rast të mungesës së tij/të saj, dhe në këtë rast ai/ajo do të ketë kompetenca dhe detyra të njëjta si kryetari kur caktohet të zërë vendin e këtij të fundit.

e) Kryetari dhe nënkryetari nuk marrin ndonjë shpërblim ose pagesë. Në rast të mungesës së përkohshme të kryetarit dhe nënkryetarit ose të mungesës së përhershme të njërit ose të dyve, Këshilli i Anëtarëve do të emërojë zyrtarë të rinj, të përkohshëm ose të përhershëm sipas rastit, nga radhët e delegacioneve të anëtarëve.

3. Komiteti i Çështjeve Financiare dhe Administrative, komitete dhe nënkomitete të tjera

Për të lehtësuar punën e Këshillit të Anëtarëve, Këshilli do t'i jepet kompetenca për të krijuar, përveç Komitetit të Çështjeve Financiare dhe Administrative të përcaktuar në nenin 13 të kësaj Marrëveshjeje, komitete dhe nënkomitete të tjera që i çmon të dobishme për ta ndihmuar në ushtrimin e funksioneve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.



4. Sekretariati ekzekutiv

a) Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit ka një sekretariat ekzekutiv, që përbëhet nga një Drejtor Ekzekutiv, zyrtarë të lartë dhe personel të tillë që kërkohet për përmbushjen e detyrave që lindin nga kjo Marrëveshje. Funkcionet e Drejtorit Ekzekutiv dhe të zyrtarëve të lartë rregullohen nga Rregullat e Procedurës që përcaktojnë, në veçanti, detyrat e caktuara atyre.

b) Faktori i rëndësishëm në punësimin e personelit të sekretariatit ekzekutiv është nevoja për të garantuar standardet më të larta të eficiencës, kompetencës dhe integritetit. Personeli i sekretariatit ekzekutiv, në veçanti Drejtori Ekzekutiv, zyrtarët e lartë dhe menaxhimi i nivelit të mesëm do të emërohen mbi bazën e parimit të alternimit proporcional në radhët e anëtarëve dhe të ekuilibrit gjeografik.

c) Këshilli i Anëtarëve emëron Drejtorin Ekzekutiv dhe zyrtarët e lartë për një periudhë katërvjeçare. Këshilli i Anëtarëve, në përputhje me dispozitat e nenit 10, paragrafi 4 (b), vendos të rinovojë ose zgjasë ndonjë emërim për jo më shumë se një periudhë maksimumi katërvjeçare.

Këshilli i Anëtarëve cakton kushtet e tyre të emërimit, duke pasur parasysh ato që zbatohen për zyrtarët përkatës të organizatave të ngjashme ndërqeveritare.

d) Drejtori Ekzekutiv emëron personelin në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe rregulloret e personelit. Drejtori Ekzekutiv garanton se të gjitha emërimet respektojnë parimet e parashikuara në paragrafin 4 (b) të këtij neni dhe raportojnë për to te Komiteti i Çështjeve Financiare dhe Administrative.

e) Drejtori Ekzekutiv është kryezyrtari administrativ i Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe është përgjegjës ndaj Këshillit të Anëtarëve për përmbushjen e detyrave që i delegohen atij/asaj në administrimin dhe funksionimin e Marrëveshjes. Drejtori Ekzekutiv ushtron detyrat e tij/të saj dhe merr vendime menaxhimi mbi bazë kolegjiale me zyrtarë të lartë sipas dispozitave të Rregullave të Procedurës.

f) Drejtori Ekzekutiv, zyrtarët e lartë dhe anëtarë të tjerë të personelit nuk kryejnë aktivitet fitimprurës në ndonjë prej sektorëve të ndryshëm të kultivimit të ullirit dhe industrinë e produkteve të ullirit.

g) Drejtori Ekzekutiv, zyrtarët e lartë dhe personeli nuk kërkojnë ose marrin udhëzime në lidhje me detyrat e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje nga ndonjë anëtar apo ndonjë autoritet jashtë Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit. Ata do të përmbahen nga çdo veprim që mund të reflektojë në pozicionin e tyre si zyrtarë ndërkombëtarë përgjegjës vetëm ndaj Këshillit e Anëtarëve. Anëtarët duhet të respektojnë karakterin ekskluzivisht ndërkombëtar të përgjegjësisë të Drejtorit Ekzekutiv, zyrtarëve të lartë dhe duhet të shmangin ndikimin e tyre në kryerjen e detyrave.

Seksioni 2

Funksionimi i Këshillit të Anëtarëve

Neni 8

Sesionet e Këshillit të Anëtarëve

1. Këshilli i Anëtarëve do të mbledhet në selinë e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, nëse nuk vendos ndryshe. Nëse, me ftesë të ndonjë Anëtari, Këshilli i Anëtarëve vendos të takohet në ndonjë vendndodhje tjetër, ky Anëtar do të mbulojë shpenzimet shtesë që kërkohen për buxhetin e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit mbi ato që kërkohen në mbajtjen e një sesioni në seli.

2. Këshilli i Anëtarëve do të mbajë dy sesione të rregullta në vit.

3. Këshilli i Anëtarëve do të takohet në sesion të jashtëzakonshëm në çdo kohë me kërkesë të:

a) Kryetarit;

b) të paktën tre anëtarëve.

4. Njoftimi për një sesion do të jepet të paktën 60 ditë para datës së mbledhjes së parë në rast të sesioneve të rregullta, dhe preferohet 30 ditë, por jo më parë se 21 ditë para datës së mbledhjes së parë në rastin e sesioneve të jashtëzakonshme. Shpenzimet e delegacioneve për Këshillin e Anëtarëve mbuloohen nga anëtarët e interesuar.

5. Çdo Anëtar, me anë të një njoftimi me shkrim të drejtuar sekretariatit ekzekutiv para ose gjatë ndonjë sesioni të rregullt ose të jashtëzakonshëm, mund të autorizojë një anëtar tjetër të përfaqësojë interesat e tij dhe të ushtrojë të drejtën e tij për të marrë pjesë në vendimet e atij sesioni të Këshillit të Anëtarëve. Një anëtar nuk mund të përfaqësojë më shumë se një anëtar tjetër në ndonjë sesion të Këshillit të Anëtarëve.



6. Ndonjë palë ose subjekt i tretë me synim aderimin në këtë Marrëveshje dhe/ose me interes të drejtpërdrejtë në aktivitetet e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, me iniciativën e vet ose me ftesë të Këshillit të Anëtarëve dhe me pëlqimin paraprak të këtij të fundit, mund të marrë pjesë si vëzhgues në të gjitha ose pjesë të një sesioni ose sesioneve të caktuara të Këshillit të Anëtarëve.

7. Vëzhguesit nuk mbajnë statusin e anëtarëve dhe nuk kanë as kompetenca vendimmarrëse, as të drejta votuese.

Neni 9

Kuorumi për sesionet

1. Kuorumi i kërkuar për mbledhjen e një sesioni të rregullt ose të jashtëzakonshëm të Këshillit të Anëtarëve verifikohet një herë në ditën e hapjes së sesionit. Do të jetë me prani ose përfaqësim në bazë të nenit 8, paragrafi 5, të të paktën tre të katërtave të të gjithë anëtarëve.

2. Nëse kuorumi i përmendur në paragrafin e mësipërm nuk plotësohet për hapjen e sesionit plenar, Kryetari do të shtyjë sesionin për 24 orë. Kuorumi i kërkuar për hapjen e sesionit në afatin e ri të caktuar nga kryetari do të jetë prania ose përfaqësimi i të paktën dy të tretave të të gjithë anëtarëve.

3. Numri efektiv i anëtarëve të nevojshëm për kuorumin është numri i plotë pa pjesë dhjetore, që rrjedhin nga zbatimi i raporteve të përmendura më lart me numrin e përgjithshëm të anëtarëve.

Neni 10

Vendimet e Këshillit të Anëtarëve

1. Vendimet e Këshillit të Anëtarëve merren me konsensus. Të gjitha vendimet sipas këtij neni merren nga anëtarët e pranishëm ose të përfaqësuar dhe të autorizuar për të votuar në përputhje me nenin 16, paragrafi 6. Anëtarët ndërmarrin të bëjnë përpjekjet maksimale për të zgjidhur me konsensus ndonjë çështje të pazgjidhur.

2. Për çdo vendim të Këshillit të Anëtarëve që duhet të miratohet, do të kërkohet prania ose përfaqësimi i të paktën shumicës të të gjithë anëtarëve të autorizuar për të votuar në përputhje me nenin 16, paragrafi 6.

3. Konsensusi zbatohet për të gjitha vendimet e marra në lidhje me:

Përfashtimin e anëtarëve në bazë të nenit 34; Nenin 16, paragrafët 6 dhe 10;

Ndryshimet në ose zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje sipas nenit 32 dhe nenit 36.

4. Bashkëpunimin me organizatat në përputhje me nenin 12, paragrafi 2. Për vendime të tjera, nëse konsensusi nuk arrihet brenda një afati kohor të përcaktuar nga kryetari, do të zbatohet procedura e përcaktuar më poshtë:

a) Vendimmarrja në lidhje me standardet tregtare dhe rregullat zbatuese të referuara në nenin 7, paragrafi 1 (c) të kësaj Marrëveshjeje:

Si rregull i përgjithshëm, vetëm vendimet për të cilat është arritur konsensus në nivelin e duhur, siç përcaktohet nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit në Rregullat e tij të Procedurës, do t'i paraqiten Këshillit të Anëtarëve për miratim.

Nëse konsensusi nuk arrihet pas procedurës së zbatueshme në nivelin e duhur, vendimi do t'i referohet Këshillit të Anëtarëve, së bashku me raportin që përcakton vështirësitë e hasura në këtë proces dhe çdo rekomandim të përshtatshëm.

Këshilli i Anëtarëve përpiqet të marrë vendimin në fjalë me konsensusin e anëtarëve të pranishëm ose të përfaqësuar dhe të autorizuar për të votuar në përputhje me nenin 16, paragrafi 6.

Nëse konsensusi nuk mund të arrihet, vendimi do të shtyhet deri në sesionin e ardhshëm, qoftë i rregullt ose i jashtëzakonshëm.

Nëse konsensusi sërish nuk arrihet në atë sesion, vendimi, nëse është e mundur, do të shtyhet për të paktën 24 orë.

Nëse konsensusi nuk arrihet brenda afatit, vendimi do të konsiderohet i miratuar, nëse nuk kundërshtohet nga të paktën një e katërta e anëtarëve ose nga një anëtar ose anëtarë me të paktën një numër të përgjithshëm prej 100 kuota/aksione pjesëmarrjeje.

b) Çdo vendim tjetër që nuk është referuar në këtë nen, paragrafi 4 (a) më lart:

Nëse konsensusi nuk arrihet brenda një afati të përcaktuar nga kryetari, anëtarët do të marrin një votë sipas dispozitave të mëposhtme:

Çdo vendim konsiderohet i miratuar kur të paktën shumica e anëtarëve, që përfaqësojnë të paktën 86 për qind të kuotave/aksioneve të pjesëmarrjes të anëtarëve në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, janë në favor të tyre.

5. Procedurat e votimit dhe përfaqësimit të referuara në këtë nen nuk zbatohen për ata



anëtarë që nuk përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje, nëse Këshilli nuk vendos ndryshe në përputhje me të njëjtin nen.

6. Këshilli i Anëtarëve mund të marrë vendime nëpërmjet shkëmbimit të korrespondencës midis kryetarit dhe anëtarëve, pa mbajtur një sesion, me kusht që asnjë anëtar, me përjashtim të atyre anëtarëve që kanë detyrime të prapambetura, nuk e kundërshton këtë procedurë. Rregullat për zbatimin e kësaj procedure konsultimi do të formulohen nga Këshilli i Anëtarëve në Rregullat e tij të Procedurës.

Çdo vendim i marrë në këtë mënyrë do t'u komunikohet të gjithë anëtarëve nga sekretariati ekzekutiv sa më shpejt të jetë e mundur dhe do të regjistrohet në raportin përfundimtar të sesionit vijues të Këshillit të Anëtarëve.

Neni 11

Aksionet e pjesëmarrjes

1. Të gjithë anëtarët së bashku mbajnë 1,000 aksione pjesëmarrjeje. Këto aksione janë të barabarta me kontributet financiare dhe të drejtat votuese të anëtarëve.

2. Aksionet e pjesëmarrjes ndahen midis anëtarëve në raport me të dhënat burimore të secilit anëtar, të llogaritura sipas formulës së mëposhtme:

$$Q = 1/3 (p1+p2) + 1/3 (e1 + e2) + 1/3 (i1 + i2)$$

Parametrat në këtë formulë janë mesatare të shprehura në mijëra tonë metrikë, çdo fraksion i 1,000 tonëve mbi një numër të plotë nuk merret në konsideratë. Nuk mund të ketë fraksione të aksioneve të pjesëmarrjes.

q: Të dhënat burimore të përdorura për të llogaritur aksionet e pjesëmarrjes në mënyrë proporcionale.

p1: Prodhimi mesatar i vajit të ullirit të gjashtë viteve të fundit të prodhimit të ullirit.

p2: Prodhimi mesatar i ullinjve të tavolinës të gjashtë viteve të fundit të prodhimit të ullirit të konvertuara në vajin e tij të ullirit të barasvlershëm nga zbatimi i një koeficienti konvertimi të paktën 16 për qind.

e1: Eksportet mesatare (doganore) të vajit të ullirit të gjashtë viteve të fundit kalendarike, që i korrespondojnë viteve fundore të viteve të prodhimit të ullirit të marra në konsideratë për llogaritjen e p1.

e2: Eksportet mesatare (doganore) të ullinjve të tavolinës të gjashtë viteve të fundit kalendarike, që i korrespondojnë viteve fundore të viteve të prodhimit të ullirit të marra në konsideratë për llogaritjen e p2 dhe të konvertuara në ekuivalentin e vajit të tyre të ullirit me zbatimin e një koeficienti konvertimi 16 për qind.

i1: Importet mesatare (doganore) të vajit të ullirit të gjashtë viteve të fundit kalendarike, që i korrespondojnë viteve fundore të viteve të prodhimit të ullirit të marra në konsideratë për llogaritjen e p1.

i2: Importet mesatare (doganore) të ullinjve të tavolinës të gjashtë viteve të fundit kalendarike, që i korrespondojnë viteve fundore të viteve të prodhimit të ullirit të marra në konsideratë për llogaritjen e p2 dhe të konvertuara në ekuivalentin e vajit të tyre të ullirit me zbatimin e një koeficienti konvertimi 16 për qind.

3. Aksionet e pjesëmarrjes fillestare përfshihen në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje. Ato përcaktohen duke pasur parasysh mesataren e të dhënave për gjashtë vitet fundit të prodhimit të ullirit dhe vitet kalendarike për të cilat janë në dispozicion të dhëna përfundimtare.

4. Asnjë anëtar nuk mban më pak se pesë aksione pjesëmarrjeje. Nëse llogaritja duhet të japë një rezultat prej më pak se pesë aksione pjesëmarrjeje për një anëtar individual, aksioni i atij anëtari do të rritet në pesë dhe aksionet e pjesëmarrjes të anëtarëve të tjerë do të ulen në mënyrë proporcionale.

5. Këshilli i Anëtarëve, në sesionin e tij të dytë të rregullt të secilit vit kalendarik, do të miratojë aksionet e pjesëmarrjes të llogaritura sipas këtij neni. Pa cenuar paragrafin 6 të këtij neni, kjo shpërndarje do të jetë në fuqi për vitin e ardhshëm.

6. Kurdoherë që ndonjë qeveri, si përcaktohet në nenin 4, paragrafi 3, bëhet ose pushon së qeni Palë e kësaj Marrëveshjeje ose një anëtar ndryshon statusin e tij brenda kuptimit të nenit 16, paragrafi 8, për vitin e ardhshëm Këshilli i Anëtarëve do të rishpërndajë aksionet e pjesëmarrjes në raport me numrin e aksioneve të pjesëmarrjes të mbajtura nga secili anëtar në bazë të kushteve të përcaktuara në këtë nen. Në rast të aderimeve ose tërheqjeve nga kjo Marrëveshje që kryhen gjatë vitit në vazhdim, rishpërndarja do të kryhet vetëm për qëllime votimi.



Neni 12

Bashkëpunimi me organizata të tjera

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të marrë masa për konsultim dhe bashkëpunim me Kombet e Bashkuara dhe agjencitë e saj të specializuara, në mënyrë të veçantë me Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin, organizata të tjera të përshtatshme ndërqeveritare dhe organizata përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale. Këto masa mund të përfshijnë marrëveshje bashkëpunimi me institucione të një natyre financiare që mund të kontribuojnë ndaj objektivave të përcaktuara në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo Marrëveshje bashkëpunimi e vendosur ndërmjet Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe organizatave dhe/ose institucioneve ndërkombëtare të lartpërmendura, e cila përfshin detyrime të rëndësishme për Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit do të marrë miratimin paraprak të Këshillit të Anëtarëve në përputhje me nenin 10, paragrafi 3.

Zbatimi i këtij neni rregullohet nga Rregullat e Procedurës të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

KAPITULLI IV

**KOMITETI I ÇËSHTJEVE FINANCIARE
DHE ADMINISTRATIVE**

Neni 13

**Komiteti i Çështjeve Financiare dhe
Administrative**

1. Këshilli i Anëtarëve do të krijojë një Komitet të Çështjeve Financiare dhe Administrative të përbërë nga të paktën një përfaqësues të secilit anëtar. Komiteti i Çështjeve Financiare dhe Administrative do të takohet të paktën dy herë në vit para çdo sesioni të Këshillit të Anëtarëve.

2. Komiteti i Çështjeve Financiare dhe Administrative do të jetë përgjegjës për funksionet e përshkruara në këtë Marrëveshje dhe në Rregullat e Procedurës. Ai do të jetë përgjegjës, në veçanti, për:

Shqyrtimin e programit vjetor të punës së sekretariatit ekzekutiv për funksionimin e institucionit, veçanërisht në lidhje me buxhetin, rregullat financiare dhe rregullat e brendshme dhe statusore, para paraqitjes në Këshillin e

Anëtarëve për miratim në sesionin e tij të dytë të rregullt të vitit kalendarik;

Mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve të kontrollit të brendshëm të përcaktuara në Rregullat e Procedurës të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe kontrollin e zbatimit të masave financiare të referuara në këtë Marrëveshje;

Shqyrtimin e projektbuxhetit vjetor të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, të propozuar nga Drejtori Ekzekutiv. Vetëm projektbuxheti i propozuar nga Komiteti i Çështjeve Financiare dhe Administrative do t'i paraqitet Këshillit të Anëtarëve për miratim;

Shqyrtimin dhe dorëzimin çdo vit të llogarive për vitin financiar të mëparshëm të Këshillit të Anëtarëve për miratim në sesionin e tij të parë të rregullt të vitit kalendarik, së bashku me ndonjë masë tjetër që lidhet me çështjet financiare dhe administrative;

Ofrimin e këshillave dhe rekomandimeve për çështje të lidhura me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje;

Shqyrtimin dhe raportimin në Këshillin e Anëtarëve në lidhje me aplikimet për aderim nga anëtarët e rinj ose në lidhje me tërheqjen e një anëtari të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit;

Shqyrtimin e pajtueshmërisë me parimet e përcaktuara në nenin 7 për emërimet e personelit të sekretariatit ekzekutiv dhe çështje të tjera të lidhura me çështje administrative dhe organizative.

3. Komiteti për Çështjet Administrative dhe Financiare ushtron, përveç atyre funksioneve të renditura në këtë nen, çdo funksion tjetër që i është deleguar nga Këshilli në Rregullat e tij të Procedurës dhe/ose në rregulloren financiare.

4. Këshilli i Anëtarëve do të hartojë dhe miratojë rregulla të hollësishme, Rregullat e tij të Procedurës për zbatimin e këtyre dispozitave.

KAPITULLI V

DISPOZITA FINANCIARE

Neni 14

Buxheti

1. Viti financiar i korrespondon vitit kalendarik.

2. Ekziston një buxhet i vetëm që përbëhet nga dy seksione:



Seksioni I: Administrativ

Seksioni II: Operativ, duke përfshirë në veçanti standardizimin, bashkëpunimin teknik dhe promovimin.

Këshilli i Anëtarëve do të vendosë për ndonjë nënseksion shtesë të përshtatshëm, duke pasur parasysh objektivat e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

3. Buxheti financohet nga:

a) Shuma e kontributit të çdo anëtari, e cila do të vendoset në raport me aksionet e tij pjesëmarrëse të caktuara në përputhje me nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.

b) Subvencionet dhe kontributet vullnetare të anëtarëve, të cilat do të rregullohen nga dispozitat e përfshira në një marrëveshje të vendosur ndërmjet Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe Anëtarit dhurues;

c) Donacionet nga qeveritë dhe/ose burimet e tjera;

d) Forma të tjera të kontributeve shtesë, duke përfshirë shërbimet, pajisjet teknike dhe shkencore dhe/ose personel që mund të plotësojë kërkesat e programeve të miratuara;

e) çdo e ardhur tjetër.

4. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, si pjesë e zhvillimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, do të përpiqet të ofrojë asistencë financiare dhe/ose teknike bazë që mund të vihet në dispozicion nga organizata kompetente ndërkombëtare, rajonale apo kombëtare, qoftë financiare apo të ndonjë lloji tjetër.

Shumat e mësipërme do të alokohen nga Këshilli i Anëtarëve të buxheti i tij.

5. Shumat e buxhetit që nuk janë përdorur gjatë një viti kalendarik mund të mbarten në vitet kalendarike në vijim si financim paraprak i buxhetit, siç përcaktohet në rregulloren financiare.

Neni 15

Fonde të tjera

Përveç buxheteve të përcaktuara në nenin 14, Këshillit Ndërkombëtar i Ullirit mund t'i sigurohen fonde të tjera, qëllimi, funksionimi dhe justifikimi për të cilat do të rregullohen nga Rregullat e Procedurës.

Këshilli i Anëtarëve mund të autorizojë sekretariatit ekzekutiv për të menaxhuar fondet e palëve të treta. Kushtet dhe qëllimi i këtij

autorizimi dhe detyrimet që rrjedhin nga menaxhimi i këtyre fondeve duhet të përcaktohen në rregulloren financiare.

Neni 16

Pagesa e kontributeve

1. Në sesionin e tij të dytë të vitit kalendarik, Këshilli i Anëtarëve do të përcaktojë shumën e përgjithshme të buxhetit të referuar në nenin 14 të kësaj Marrëveshjeje dhe kontributin që do të paguhet nga secili anëtar për vitin kalendarik në vijim. Ky kontribut do të llogaritet në bazë të aksioneve të pjesëmarrjes të secilit anëtar, siç është përcaktuar në nenin 11 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Këshilli i Anëtarëve vlerëson kontributin fillestar të çdo anëtari i cili bëhet Palë e kësaj Marrëveshjeje pas hyrjes së saj në fuqi. Ky kontribut do të llogaritet në bazë të aksioneve të pjesëmarrjes të caktuara për këtë anëtar sipas nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje, siç zbatohet për pjesën e papërfunduar të vitit në fjalë. Shuma e kontributit që duhet të paguhet nga anëtarë të tjerë për atë vit kalendarik nuk do të ndryshohet.

3. Kontributet janë të pagueshme në euro dhe të kërkueshme nga dita e parë e vitit financiar, që është në datën 1 janar të çdo viti.

Kontributet e anëtarëve për vitin financiar gjatë të cilit ata bëhen anëtarë të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, janë të kërkueshme në datën kur bëhen anëtarë.

4. Nëse një anëtar nuk ka shlyer kontributin e tij plotësisht brenda katër muajve pas datës në të cilën kontributet bëhen të kërkueshme, sekretariati ekzekutiv do t'i shkruajë anëtarit në fjalë brenda shtatë ditësh, me qëllim që t'i kërkojë atij anëtari kryerjen e pagesës.

5. Nëse, pas skadimit të një afati prej dy muajsh nga data e kërkesës së bërë nga sekretariati ekzekutiv, anëtari në fjalë nuk ka shlyer ende kontributin e tij, të drejtat votuese të atij anëtari në Këshillin e Anëtarëve do të pezullohen deri në kohën kur të ketë kryer pagesën e plotë të kontributit të tij.

Përfaqësuesit e anëtarit në fjalë gjithashtu do të pezullohen nga mbajtja e postit zgjedhor në Këshillin e Anëtarëve, si dhe në komitete dhe nënkomitete dhe nga pjesëmarrja në aktivitete të financuara nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit në vitin e ardhshëm.



6. Në sesionin e parë të rregullt të vitit kalendarik ose sesionin e jashtëzakonshëm pas afatit për kontributet, Këshilli i Anëtarëve do të informohet nëse një anëtar nuk ka shlyer kontributin e tij. Këshilli i Anëtarëve, me përjashtim të anëtarit me pagesa të prapambetura, pas dëgjimit të këtij të fundit dhe duke marrë parasysh situatën e tij specifike, të tillë si: konfliktet, fatkeqësitë natyrore ose vështirësi në qasje ndaj shërbimeve financiare ndërkombëtare, mund të marrë ndonjë vendim tjetër me konsensus. Këshilli i Anëtarëve mund të përshtatë programin e punës së sekretariatit ekzekutiv, duke pasur parasysh kontributet e paguara efektivisht nga anëtarët.

7. Dispozitat e paragrafëve 5 dhe 6 të këtij neni zbatohen derisa kontributet të paguhen plotësisht nga anëtarë në fjalë.

8. Pas dy viteve të njëpasnjëshme të kontributeve të papaguara, Këshilli i Anëtarëve, pas dëgjimit të anëtarit që ka pagesa të prapambetura, mund të vendosë që ky i fundit të pushojë gëzimin e të drejtave të anëtarësisimit, por mund të marrë pjesë në sesione si vëzhgues brenda kuptimit të nenit 8, paragrafi 7.

9. Çdo anëtar që tërhiqet nga Marrëveshja mbetet përgjegjës për të paguar ndonjë prej detyrimeve të tij financiare sipas kësaj Marrëveshjeje dhe nuk ka të drejtën e ndonjë rimbursimi të ndonjë kontributi financiar që tashmë ka shlyer.

10. Në asnjë rast, Këshilli i Anëtarëve nuk mund të çlirojë një anëtar nga detyrimet e tij financiare në bazë të kësaj Marrëveshjeje. Këshilli i Anëtarëve mund të bjerë dakord me konsensus për riskedulimin e detyrimeve financiare të anëtarëve të pranishëm dhe të mëparshëm.

Neni 17 Kontrolli

1. Kontrolli financiar i Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit do të kryhet nga Komiteti i Çështjeve Financiare dhe Administrative.

2. Pasqyrat financiare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit të vitit kalendarik të mëparshëm, të certifikuara nga një auditues i pavarur, do t'i paraqiten Komitetit të Çështjeve Financiare dhe Administrative, i cili pas analizës së llogarive, në sesionin e tij të parë të rregullt të vitit kalendarik, do t'i paraqesë një opinion

Këshillit të Anëtarëve për miratim dhe publikim.

Në kryerjen e punës së lartpërmendur audituese, audituesit e pavarur do të verifikojnë përputhshmërinë me rregulloren financiare në fuqi, si dhe funksionimin dhe eficiencën e mekanizmave ekzistues të kontrollit të brendshëm dhe do të regjistrojnë punën e kryer dhe incidentet e gjetura në një raport vjetor, i cili do t'i paraqitet Komitetit të Çështjeve Financiare dhe Administrative.

Raporti i auditimit do t'i paraqitet Këshillit të Anëtarëve në sesionin e tij të parë të rregullt.

Këshilli i Anëtarëve do të caktojë audituesin e pavarur, i cili do të jetë përgjegjës për analizimin e llogarive vjetore të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe për formulimin e raportit të lartpërmendur, të dyja sipas dispozitave të rregullores financiare dhe procedurave të saj zbatuese.

3. Përveç kësaj, Këshilli i Anëtarëve, në sesionin e tij të parë të rregullt të vitit kalendarik do të shqyrtojë dhe miratojë raportin financiar për vitin e mëparshëm kalendarik në lidhje me:

Verifikimin e menaxhimit të fondeve, sendeve pasurore dhe mjeteve monetare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit;

Rregullsinë e operacioneve financiare dhe përputhshmërinë e tyre me rregullat, rregulloret dhe dispozitat buxhetore në fuqi.

4. Kontrollat *ex-post* të operacioneve sigurohen nga auditues të jashtëm në përputhje me dispozitat e rregullores financiare.

5. Në bazë të një analize risku, një numër minimal prej tre anëtarësh mund t'i kërkojë Këshillit autorizim për të kryer kontrole për aktivitetet e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit për të garantuar përputhshmëri me rregullat në fuqi dhe parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar dhe transparencë.

Kontrollet do të kryhen në bashkëpunim të ngushtë me anëtarët e sekretariatit ekzekutiv të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në Rregullat e Procedurës dhe rregulloren financiare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

Raporti përkatës i paraqitet Këshillit të Anëtarëve në sesionin e parë plenar pas përfundimit të raportit.



Neni 18 Likuidimi

1. Këshilli i Anëtarëve, nëse shpërbëhet, do të marrë fillimisht hapat e përcaktuar në nenin 35, paragrafi 1.

2. Me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, sendet pasurore të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit dhe çdo shumë e papërdorur që rrjedhin nga fondet e referuara në nenin 14 do t'i shlyhen anëtarëve në raport me totalin e aksioneve të tyre të pjesëmarrjes në fuqi në atë kohë.

Kontributet vullnetare dhe donacionet e referuara në nenin 14, si dhe shumat e papërdorura të referuara në nenin 15 do t'i shlyhen anëtarit, donatorit ose palës së tretë përkatëse.

KAPITULLI VI DISPOZITAT E STANDARDIZIMIT

Neni 19 Llojet dhe përkufizimet e vajrave të ullirit, vajrave të bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës

1. Llojet dhe përkufizimet e vajrave të ullirit, vajrave të bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës përshkruhen në shtojcat B dhe C të kësaj Marrëveshjeje.

2. Këshilli i Anëtarëve mund të bëjë të gjitha ato ndryshime që i çmon të nevojshme ose të përshtatshme për llojet dhe përkufizimet e vajrave të ullirit, vajrave të bërsisë së ullirit dhe ullinjve të tavolinës të parashikuar në shtojcat B dhe C të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 20 Zotimet e anëtarëve

1. Anëtarët e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit zotohen të zbatojnë emërtimet e parashikuara në shtojcat B dhe C në tregtinë e tyre ndërkombëtare dhe do të nxisin zbatimin e tyre në tregtinë e tyre të brendshme.

2. Anëtarët zotohen të shmangin në tregtinë e tyre të brendshme dhe ndërkombëtare çdo përdorim të emërtimit “vaj ulliri”, vetëm ose në kombinim me fjalë tjera, e cila nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje. Në asnjë rast emërtimi “vaj ulliri” nuk do të përdoret vetëm për t'iu referuar vajit të bërsisë së ullirit.

3. Këshilli i Anëtarëve do të përcaktojë standardet e kritereve të cilësisë dhe pastërtisë të zbatueshme në tregtinë ndërkombëtare të anëtarëve.

4. Anëtarët garantojnë mbrojtje në territorin e tyre për treguesit gjeografikë brenda kuptimit të nenit 22, paragrafi 1 i Marrëveshjes për Aspektet e lidhura me Tregtinë të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (Marrëveshja TRIPS) në lidhje me produktet e mbuluara nga kjo Marrëveshje, në përputhje me rregullat, procedurat dhe zotimet ndërkombëtare të zbatueshme, në veçanti nenin 1 të Marrëveshjes TRIPS.

5. Anëtarët, sipas kërkesës, shkëmbejnë informacion për treguesit gjeografikë të cilëve u jepet mbrojtje në territorin e tyre, me synim në veçanti, forcimin e mbrojtjes së tyre ligjore nga ndonjë praktikë që mund të cenojë autenticitetin ose reputacionin e tyre.

6. Anëtarët autorizohen të miratojnë iniciativa të parashikuara për të informuar konsumatorët mbi karakteristikat specifike të treguesve të mbrojtur gjeografikë në territorin e tyre dhe për t'i shtuar vlerë këtyre treguesve, në përputhje me dispozitat e zbatueshme ligjore.

Neni 21 Etiketa ndërkombëtare e garancisë e Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit

Këshilli i Anëtarëve mund të marrë masa për aplikimin e etiketës së garancisë ndërkombëtare të cilësisë, duke garantuar pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit. Zbatimi i këtij neni dhe dispozitat e kontrollit përcaktohen në Rregullat e Procedurës.

KAPITULLI VII DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 22 Detyrime të përgjithshme

Anëtarët nuk do të miratojnë masa që janë në kundërshtim me detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje ose me objektivat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 1.



Neni 23

Përgjegjësia financiare e anëtarëve

Përgjegjësia financiare e secilit anëtar në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit dhe ndaj anëtarëve të tjerë kufizohet në masën e detyrimeve të tij sipas nenit 16 në lidhje me kontributet për buxhetin e referuar në të njëjtin nen.

Neni 24

Aspektet mjedisore dhe ekologjike

Anëtarët i japin vëmendjen e duhur përmirësimit të praktikave në të gjitha fazat e prodhimit të ullirit dhe vajit të ullirit, me qëllim garantimin e zhvillimit të rritjes së qëndrueshme të ullirit dhe ndërmerr të zbatojë atë masë që mund të çmohet e nevojshme nga Këshilli i Anëtarëve për të përmirësuar ose zgjidhur problemet e hasura në këtë fushë.

Neni 25

Informacioni

Anëtarët ndërmarrin të vënë në dispozicion dhe t'i japin Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit të gjitha statistikat, të dhënat dhe dokumentacionin që nevojitet për të përmbushur funksionet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, çdo informacion që kërkon me qëllim krijimin e balancave për vajrat e ullirit, vajrat e bërsisë së ullirit dhe ullinjtë e tavolinës dhe për të marrë njohuri për politikën kombëtare të anëtarëve për produktet e ullirit.

Neni 26

Mosmarrëveshjet dhe ankesat

1. Çdo mosmarrëveshje që lidhet me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe që nuk zgjidhet me negociim, me kërkesë të ndonjë anëtari ose anëtarëve që janë palë të mosmarrëveshjes, do t'i referohet Këshillit të Anëtarëve, i cili do të marrë një vendim në mungesë të anëtarit ose anëtarëve përkatës pas kërimit të një opinionit, sipas rastit, nga një panel këshillimor. Përbërja dhe të dhënat operationale të këtij paneli përcaktohen në Rregullat e Procedurës.

2. Një opinion i bazuar nga paneli këshillimor i paraqitet Këshillit të Anëtarëve, i cili në të gjitha rrethanat do të zgjidhë mosmarrëveshjen pas shqyrtimit të fakteve përkatëse.

3. Çdo ankesë që një anëtar, kryetari ose nënkryetari që vepron si kryetar, nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje, me kërkesë të anëtarit që bën ankesën, do t'i referohet Këshillit të Anëtarëve. Këshilli merr një vendim në mungesë të palës ose palëve të përfshira pas konsultimit të palëve të interesuara dhe pas kërimit të një opinionit, sipas rastit, nga paneli këshillimor i referuar në paragrafin 1 të këtij neni. Zbatimi i këtij paragrafi përcaktohet më tej në Rregullat e Procedurës.

4. Nëse Këshilli i Anëtarëve konstaton se një anëtar ka kryer një shkelje të kësaj Marrëveshjeje, ai ose mund të vendosë ndaj atij anëtari sanksione që variojnë nga një paralajmërim i thjeshtë te pezullimi i të drejtës së anëtarit për të marrë pjesë në vendimet e Këshillit të Anëtarëve, derisa të ketë përmbushur detyrimet e tij ose në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 34, mund të përjashtojë anëtarin nga pjesëmarrja në Marrëveshje. Anëtari në fjalë ka të drejtën e rekursit në shkallën e fundit të Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë.

5. Nëse Këshilli i Anëtarëve çmon se kryetari ose nënkryetari që vepron si kryetar nuk ka përmbushur detyrat e tij/të saj në përputhje me këtë Marrëveshje ose Rregullat e Procedurës, me kërkesë të të paktën 50 për qind të anëtarëve të pranishëm, mund të vendosë ose për një sesion, ose për një periudhë më të gjatë, të pezullojë përkohësisht kompetencat dhe funksionet e dhëna kryetarit ose nënkryetarit në këtë Marrëveshje ose në Rregullat e Procedurës dhe për të emëruar një zëvendësues në radhët e anëtarëve të Këshillit. Zbatimi i këtij paragrafi përcaktohet më tej në Rregullat e Procedurës.

6. Për sa i përket ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me transaksionet në vajrat e ullirit, vajrat e bërsisë së ullirit dhe ullinjtë e tavolinës, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të bëjë rekomandimet e përshtatshme për anëtarët në lidhje me përbërjen dhe funksionimin e një zyre ndërkombëtare pajtimi dhe arbitrazhi për trajtimin e këtyre mosmarrëveshjeve.

Neni 27

Depozitari

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara me anë të kësaj caktohet si depozitar i kësaj Marrëveshjeje.



Neni 28

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi dhe miratimi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për nënshkrim në Selinë e Kombeve të Bashkuara nga data 1 janar 2016 deri më dhe duke përfshirë datën 31 dhjetor 2016 nga palët e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinj të Tavolinës, 2005, dhe qeveritë e ftuara në Konferencën e Kombeve të Bashkuara për Negocimin e një Marrëveshjeje Vijuese të Marrëveshjes Ndërkombëtare për Vajin e Ullirit dhe Ullinj të Tavolinës, 2005.

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga Qeveritë nënshkruese në përputhje me procedurat e tyre përkatëse kushtetuese.

2. Çdo Qeveri e referuar në nenin 4, paragrafi 3:

a) Në kohën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, mund të deklarojë me shkrim se, me anë të një nënshkrimi të tillë, shpreh pëlqimin e saj për të pasur detyrim ligjor sipas kësaj Marrëveshjeje (nënshkrimi përfundimtar); ose

b) pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje mund ta ratifikojë, pranojë ose miratojë me anë të depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim te depozitari.

3. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit depozitohen te depozitari.

Neni 29

Aderimi

1. Kjo Marrëveshje do të jetë e hapur për aderim nga çdo qeveri e përcaktuar në nenin 4, paragrafi 3, e cila mund të aderojë në këtë Marrëveshje në bazë të kushteve që do të përcaktohen nga Këshilli i Anëtarëve, i cili do të ketë në veçanti numrin e aksioneve të pjesëmarrjes dhe një afat kohor për depozitimin e instrumentit të aderimit. Këto kushte i transmetohen depozitarit nga Këshilli i Anëtarëve. Procedura për fillimin e aderimit, bisedimet për aderimin dhe dispozitat përkatëse përcaktohen nga Këshilli i Anëtarëve në Rregullat e Procedurës.

2. Kur bisedimet për negociim të përcaktuara në Rregullat e Procedurës kanë përfunduar, Këshilli i Anëtarëve do të marrë një vendim për

aderimin në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 10.

3. Pas aderimit, një Palë Kontraktuese do të renditet në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me aksionet e saj pjesëmarrëse të përcaktuara në kushtet e aderimit.

4. Aderimi kryhet me anë të depozitimit të një instrumenti aderimi te depozitari. Instrumentet e aderimit deklarojnë se qeveria pranon të gjitha kushtet e vendosura nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit.

Neni 30

Njoftimi i zbatimit të përkohshëm

1. Një qeveri nënshkruese e cila synon të ratifikojë, pranojë apo të miratojë këtë Marrëveshje apo një qeveri për të cilën Këshilli i Anëtarëve ka vendosur kushtet e aderimit, por e cila nuk ka qenë e aftë të depozitonte instrumentin e tij, në çdo kohë mund të njoftojë depozitarin që ai do të zbatojë këtë Marrëveshje në mënyrë të përkohshme kur ajo hyn në fuqi në përputhje me nenin 31 apo nëse është tashmë në fuqi në një datë të specifikuar.

2. Një qeveri e cila ka paraqitur një njoftim të zbatimit të përkohshëm në bazë të paragrafit 1 të këtij neni, do ta zbatojë këtë Marrëveshje kur ajo të hyjë në fuqi ose nëse është tashmë në fuqi, në një datë të specifikuar, dhe nga kjo kohë do të jetë një Palë Kontraktuese. Ajo do të vazhdojë të jetë Palë Kontraktuese deri në datën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit.

Neni 31

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë përfundimisht në fuqi në datën 1 janar 2017, me kusht që të paktën pesë nga Palët Kontraktuese ndërmjet atyre, të cituara në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje, dhe që llogariten për të paktën 80 për qind të aksioneve pjesëmarrëse nga 1,000 aksione pjesëmarrëse kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht apo e kanë ratifikuar, pranuar, apo miratuar atë, apo aderuar në të.

2. Nëse në datën 1 janar 2017 kjo Marrëveshje nuk ka hyrë në fuqi në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ajo do të hyjë në fuqi përkohësisht nëse deri në atë datë Palët Kontraktuese, që



plotësojnë kërkesat e përqindjes të paragrafit 1 të këtij neni, kanë nënshkruar përfundimisht këtë Marrëveshje apo e kanë ratifikuar, pranuar apo miratuar atë, apo kanë njoftuar depozitarin që ato do të zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht.

3. Nëse më 31 dhjetor 2016, kërkesat për hyrjen në fuqi në bazë të paragrafit 1 apo 2 të këtij neni nuk janë plotësuar, depozitari do të ftojë ato Palë Kontraktuese që kanë nënshkruar këtë Marrëveshje përfundimisht apo e kanë ratifikuar, pranuar apo miratuar atë, apo kanë njoftuar që ato do të zbatojnë këtë Marrëveshje përkohësisht, të vendosin nëse e shpallin në fuqi këtë Marrëveshje përfundimisht apo përkohësisht midis tyre, plotësisht apo pjesërisht në datën kur ato mund ta përcaktojnë.

4. Për çdo Palë Kontraktuese, e cila depoziton një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit.

Neni 32

Amendimet (Ndryshimet)

1. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, duke vepruar nëpërmjet Këshillit të Anëtarëve, mund të amendojë (ndryshojë) këtë Marrëveshje me konsensus.

2. Këshilli i Anëtarëve cakton datën në të cilën anëtarët do të njoftojnë depozitarin për pranimin nga ana e tyre të mendimit (ndryshimit) në fjalë.

3. Amendimi (Ndryshimi) do të hyjë në fuqi 90 ditë pasi depozitari të ketë marrë njoftimin për pranimin e tij nga të gjithë anëtarët. Nëse kjo kërkesë nuk përmbushet deri në datën e caktuar nga Këshilli i Anëtarëve, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, mendimi (ndryshimi) do të konsiderohet i tërhequr.

4. Përditësimet në shtojcën A në bazë të nenit 11, paragrafi 5, për qëllimet e këtij neni, nuk do të konsiderohen amendime (ndryshime).

Neni 33

Tërheqja

1. Çdo anëtar mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje në çdo kohë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, duke i dhënë një njoftim me shkrim depozitarit në lidhje me tërheqjen.

Anëtar i njëkohësisht do të informojë me shkrim për veprimin e marrë Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit.

2. Tërheqja në bazë të këtij neni do të bëhet efektive 90 ditë pasi njoftimi të jetë marrë nga depozitari.

Neni 34

Përrjashtimi

Pa cenuar nenin 26, nëse Këshilli i Anëtarëve vendos që ndonjë anëtar shkel detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje dhe vendos më tej që kjo shkelje cenon ndjeshëm funksionimin e kësaj Marrëveshjeje, me një vendim të arsyeshëm, të marrë me konsensus, të anëtarëve të tjerë dhe të marrë në mungesë të anëtarit përkatës, mund të përjashtojë këtë anëtar nga kjo Marrëveshje. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të njoftojë menjëherë depozitarin për vendimin e tij. Anëtar i në fjalë do të pushojë të jetë Palë e kësaj Marrëveshjeje 30 ditë pas datës së vendimit të Këshillit të Anëtarëve. Pas datës së vendimit nuk do të lindë asnjë detyrim i ri financiar për përjashtimin e anëtarit.

Neni 35

Shlyerja e llogarive

1. Këshilli i Anëtarëve do të përcaktojë çdo shlyerje të llogarive të cilat ai i çmon të barasvlershme, duke pasur parasysh të gjitha angazhimet që shkaktojnë pasoja juridike për Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit dhe që do të kishin pasoja për kontributin e një anëtar i që është tërhequr nga kjo Marrëveshje ose që është përjashtuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit, ose ndryshe ka pushuar të jetë Palë në këtë Marrëveshje, si dhe periudha e nevojshme për të garantuar një tranzicion të mjaftueshëm, në veçanti kur angazhime të tilla duhet të përfundojnë.

Pavarësisht nga dispozitat e nënparagrafit më lart, një anëtar i tillë do të jetë i detyruar ligjërisht të paguajë çdo shumë të kërkueshme prej tij në Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit në lidhje me periudhën gjatë të cilit ishte anëtar.

2. Pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, asnjë anëtar i referuar në paragrafin 1 të këtij neni nuk do t'i jepet e drejta për ndonjë pjesë të të ardhurave të likuidimit apo të sendeve të tjera pasurore të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit; as



nuk do të ngarkohet me ndonjë pjesë të deficitit, nëse ka, të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

Neni 36

Kohëzgjatja, shtyrja dhe përfundimi

1. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2026.

2. Këshilli i Anëtarëve mund të zgjasë këtë Marrëveshje. Këshilli i Anëtarëve do të njoftojë depozitarin për ndonjë zgjatje të tillë. Çdo anëtar i cili nuk pranon ndonjë zgjatje të tillë të kësaj Marrëveshje, do të informojë Këshillin Ndërkombëtar të Ullirit dhe do të pushojë së qeni Palë Kontraktuese e kësaj Marrëveshje nga fillimi i periudhës së zgjatjes.

3. Nëse para 31 dhjetorit 2026 apo para përfundimit të periudhës së zgjatjes të vendosur nga Këshilli i Anëtarëve një marrëveshje e re është negociuar nga Këshilli i Anëtarëve, por ende nuk ka hyrë në fuqi përfundimisht apo përkohësisht, kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi pas datës së saj të përfundimit derisa marrëveshja e re të hyjë në fuqi për një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh.

4. Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit mund të vendosë të përfundojë këtë Marrëveshje me konsensus. Detyrimet e anëtarëve do të vazhdojnë deri në datën e përfundimit të përcaktuar nga Këshilli i Anëtarëve.

5. Pavarësisht skadimit apo përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, Këshilli Ndërkombëtar i Ullirit do të vazhdojë të jetë për aq kohë sa mund të jetë e nevojshme me qëllim të realizimit të likuidimit të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit, duke përfshirë shlyerjen e llogarive, dhe gjatë kësaj periudhe do të ketë funksione dhe kompetenca të tilla që mund të jenë të nevojshme për këto qëllime.

6. Këshilli i Anëtarëve do të njoftojë depozitarin për çdo vendim të marrë në bazë të këtij neni.

Neni 37

Rezervat

Asnjë rezervim nuk mund të bëhet në lidhje me ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje.

NË DËSHMI TË KËSAJ, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar sipas rregullave për këtë, kanë vendosur nënshkrimin e tyre sipas kësaj Marrëveshjeje në datat e përcaktuara.

BËRË në Gjenevë, më 9 tetor 2015, tekstet e kësaj Marrëveshjeje në gjuhët arabe, angleze, frënge dhe spanjolle, duke qenë njëloj autentike.

Shtojca A

Aksionet e pjesëmarrjes në buxhetin e organizatës, siç përcaktohen në përputhje me nenin 11

Shqipëria	5
Algjeria	19
Argjentina	18
Egjipti	23
Bashkimi Evropian	717
Republika Islamike e Iranit	5
Iraku	5
Izraeli	5
Jordania	8
Libani	6
Libia	5
Maroku	41
Mali i Zi	5
Tunizia	67
Turqia	66
Uruguai	5
Totali	1,000

SHTOJCA B

KATEGORITË DHE PËRKUFIZIMET E VAJRAVE TË ULLIRIT DHE VAJRAVE TË BËRSISË SË ULLIRIT

Llojet e vajrave të ullirit dhe vajrave të bërsisë së ullirit jepen më poshtë me përkufizimin që i korrespondon çdo kategorie:

I. Vajrat e ullirit

A. Vajra ulliri të virgjër: vajrat të cilët merren nga fruti i pemës së ullirit (*Olea europaea L.*) vetëm me mjete mekanike apo mjete të tjera fizike në kushte, veçanërisht kushtet termike që nuk shkaktojnë përkeqësim të vajit dhe që nuk i janë nënshtruar ndonjë trajtimi përveç larjes, dekantimit, centrifugimit dhe filtrimit. Vajrat e ullirit të virgjër do të klasifikohen dhe përcaktohen si vijon:

a) Vajra ulliri të virgjër të përshtatshëm për konsum në gjendjen që janë:

i) Vaj ulliri ekstra i virgjër: Vaj ulliri i virgjër, karakteristikat fiziko-kimike dhe organoleptike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për



këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit;

ii) Vaj ulliri i virgjër: Vaj ulliri i virgjër, karakteristikat fiziko-kimike dhe organoleptike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit;

iii) Vaj ulliri i virgjër i zakonshëm: vaj ulliri i virgjër, karakteristikat fiziko-kimike dhe organoleptike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.¹

b) Vajrat e ullirit të virgjër që duhet t'i nënshtrohen përpunimit para konsumit:

Vaj ulliri i virgjër lampant: Vaj ulliri i virgjër, karakteristikat fiziko-kimike dhe organoleptike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit. Ai synohet për rafinim për përdorim për konsum njerëzor ose synohet për përdorim teknik.

B. Vaj ulliri i rafinuar: vaj ulliri i marrë nga përpunimi i vajrave të ullirit të virgjër, karakteristikat fiziko-kimike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.²

C. Vaj ulliri i përbërë nga vaj ulliri i rafinuar dhe vajra ulliri të virgjër: Vaj që përbëhet nga një përzierje e vajit të ullirit të rafinuar dhe vajrave të ullirit të virgjër të përshtatshëm për konsum në gjendjen që janë, karakteristikat fiziko-kimike të të cilëve i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

II. Vaji i bërsisë së ullirit³ është vaji i marrë duke përpunuar vajin e bërsisë së ullirit me tretës apo me trajtime të tjera fizike, me përjashtim të vajrave të marrë nga proceset e riesterifikimit dhe çdo përzierje tjetër me vajra të llojeve të tjera. Ato klasifikohen si vijon:

A. Vaj i bërsisë së ullirit i papërpunuar: Vaj i bërsisë së ullirit, karakteristikat fiziko-kimike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit. Ai synohet për përpunim për përdorim për konsum njerëzor ose synohet për përdorim teknik.

B. Vaj i bërsisë së ullirit i përpunuar: vaji përftohet nga përpunimi i vajit të papërpunuar të bërsisë së ullirit, karakteristikat fiziko-kimike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit⁴.

C. Vaj i bërsisë së ullirit, ulliri që përbëhet nga një përzierje e vajit të përpunuar të bërsisë së ullirit me vajra ulliri të virgjër. Vaji i përbërë nga një përzierje e vajit të rafinuar të bërsisë së ullirit dhe vajrave të ullirit të virgjër të përshtatshëm për konsum në gjendjen e tyre aktuale, karakteristikat fiziko-kimike të të cilit i korrespondojnë atyre të përcaktuara për këtë kategori në standardin tregtar të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

SHTOJCA C LLOJET DHE PËRKUFIZIMET E ULLINJVE TË TAVOLINËS

Ullinj të tavolinës klasifikohen në një nga llojet si vijon:

i) Ullinj jeshilë: frutat e vjela gjatë periudhës së pjekjes, para se të marrin ngjyrën dhe kur kanë arritur madhësinë normale. Ato mund të ndryshojnë në ngjyrë nga jeshile në ngjyrë të verdhë kashte.

ii) Ullinj të ndryshojnë ngjyrë: frutat e vjela para se të jetë arritur faza e pjekjes së plotë me ndryshimin e ngjyrës. Ato mund të ndryshojnë në ngjyrë nga rozë në rozë si e verës apo ngjyrë kafe.

iii) Ullinj të zinj: frutat e vjela kur janë të pjekur plotësisht ose lehtësisht para se të jetë arritur pjekja e plotë. Ato mund të ndryshojnë ngjyrë nga e zeza e kuqërreme në të zezë vjollcë, vjollcë e thellë, e zezë në jeshile apo ngjyrë gështenjë e thellë.

¹ Ky produkt mund të shitet vetëm drejtpërdrejt për konsumatorin, nëse lejohet në vendin e shitjes me pakicë. Nëse nuk lejohet, emërtimi i këtij produkti do të pajtohet me dispozitat ligjore të vendit të interesuar.

² Ky produkt mund t'i shitet drejtpërdrejt konsumatorit, nëse lejohet në vendin e shitjes me pakicë.

³ Ky produkt mund të shitet vetëm drejtpërdrejt te konsumatori, nëse lejohet në vendin e shitjes me pakicë.

⁴ Vaji i pulpës së ullirit nuk mund të shitet me llojin ose përkufizimin "vaj ulliri".



Përgatitjet për tregtim të ullinjve të tavolinës, duke përfshirë në veçanti tipat e përpunimit, rregullohen nga standarde të zbatueshme tregtare të Këshillit Ndërkombëtar të Ullirit.

LIGJ
Nr. 113/2017

**PËR RATIFIKIMIN E DOKUMENTEVE
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD),
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË
MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS
SOCIALE, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 84/2012**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 dhe 2, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohen dokumentet ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit të modernizimit të asistencës sociale, ratifikuar me ligjin nr. 84/2012, sipas teksteve që i bashkëlidhen këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.12.2017

Shpallur me dekretin nr. 10704, datë 26.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

Banka Botërore Zyra e Grupit të Bankës
Botërore
IBRD-IDA - Grupi i Praterstrasse 31/21
Bankës Botërore Vienna, Austria, 1020

Ellen Goldstein
Drejtoreshë për Vendlindjen, Rajonin e Ballkanit
dhe Azisë Qendrore

6 shkurt 2017

Sh.t. Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Nr. 4, Tiranë
Republika e Shqipërisë

**Lënda: Republika e Shqipërisë: Projekti
për Modernizimin e Asistencës Sociale
(Numri i Huas: 8141-AL)
Zgjatje e datës së mbylljes**

Shkëlqesi,

I referohemi Marrëveshjes së Huas (Marrëveshja), të datës 6 qershor 2012, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), për projektin e lartpërmendur dhe letrës suaj të datës 26 janar 2017, me anë të së cilës i kërkon Bankës Botërore të zgjasë datën e mbylljes së huas të titulluar më sipër, të parashikuar sipas Marrëveshjes së Huas.

Kam kënaqësinë t'ju informoj se Banka Botërore ka përcaktuar datën 31 dhjetor 2018, si datë të mëvonshme për qëllimet e seksionit IV.B.4, të skedulit 2 të Marrëveshjes së Huas.

Me respekt,

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Nga _____

Ellen Goldsetin

Drejtoreshë për Vendlindjen, Rajonin e Ballkanit
Perëndimor, Evropës dhe Azisë Qendrore
Tel.: +43 (1) 2170 782
Fax: +43 (1) 2170 701



Maryam Salim
Menaxhere
Zyra e Bankës
Botërore, Shqipëri
Rajoni i Evropës dhe
Azisë Qendrore
Rruga “Ibrahim Rugova”
Vila nr. 34,
Tiranë, Shqipëri
Tel.: (355) 42280 650/51
Faks: (355) 42240 590
Email: Msalim
1@worldbank.org
14 gusht 2017

Sh.s. Helga Vukaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Nr. 4, Tiranë
Republika e Shqipërisë

8141-AL
**Projekti i Modernizimit të Asistencës
Sociale
Korrigjim**

Shkëlqesi,

I referohemi Marrëveshjes së Huas për Projektin e Modernizimit të Asistencës Sociale ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka), të datës 6 qershor 2012, të ndryshuar (Marrëveshja e Huas), për kredinë e lartpërmendur (Huamarrësi).

Vërejmë se në ndryshimin e Marrëveshjes së Huas, të datës 16 maj 2016 (Amendamenti), janë përjashtuar pa dashje taksat nga shpenzimet që financohen nga të ardhurat e Huas. Duke pasur parasysh këtë, lutemi gjeni më poshtë tabelën e korrigjuar që do të zëvendësojë tabelën sipas seksionit IV.A.2, të shtojcës 2 të Marrëveshjes së Huas:

Lënda: Republika e Shqipërisë: Kredia nr.

Kategoria	Shuma e huas së alokuar (shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve (për t'u financuar)
1. Pagesa për programin e shpenzimeve të miratuara në kuadër të pjesës 1 të projektit	35,115,000	Shuma e treguesve të lidhur me disbursimin e përcaktuar në shtojcën e programit 2 të kësaj marrëveshjeje
2. Shërbimet e konsulentëve në kuadër të pjesës 2 të projektit dhe kostot operative	2,790,000	100%
3. Tarifa fillestare	95,000	Shuma e pagueshme në bazë të seksionit 2.03 të kësaj marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.07(b) të kushteve të përgjithshme
SHUMA TOTALE	38,000,000	

Ky korrigjim hyn në fuqi që nga data e kësaj letre. Ne do të vlerësojmë nëse mund të na dërgoni konfirmimin tuaj sa më të shpejtë për marrjen e kësaj letre.

Me respekt,

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

Evis Sulko

Drejtoreshë e Komanduar

Për dënim: Z. Erjon Luçi, zëvendësministër i Financave

Z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv, Banka Botërore



LIGJ
Nr. 114/2017

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.
93/2015, “PËR TURIZMIN”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin” bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 4, “Përkufizime”, pas pikës 52 shtohen pikat 53, 54 dhe 55 me këtë përmbajtje:

“53. “Strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënkupton strukturën akomoduese, që përfshin hotelin dhe/ose resortin me 4 ose 5 yje, e cila përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/2 të këtij ligji.

54. “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënkupton subjektin, i cili financon ndërtimin dhe/ose merr përsipër ndërtimin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, i cili përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/1 të këtij ligji.

55. “Operator menaxhues në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënkupton grupin hotelier, i cili merr përsipër operimin dhe menaxhimin e një strukture akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, drejtpërdrejt apo nëpërmjet kontratave “*franchising*” apo kontratave të tjera, të ngjashme me këtë të fundit.”.

Neni 2

Pas nenit 33 shtohen nenet 33/1 dhe 33/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1

Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special

Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin, jep statusin e veçantë “Investitor në strukturë akomoduese me

4 ose 5 yje, status special” për subjektin që plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, në Republikën e Shqipërisë, të certifikuar si e tillë nga struktura përgjegjëse, sipas këtij ligji;

b) vlera e investimit është të paktën 8 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe të paktën 15 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 5 yje.

Neni 33/2

Aplikimi për statusin “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” dhe marrëveshja me investitorin

1. Kriteret e tjera, procedurat dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë subjektet që duan të aplikojnë për statusin “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për turizmin.

2. Subjektet, që përfitojnë statusin “Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënshkruajnë marrëveshje zhvillimi me ministrinë përgjegjëse për turizmin, në të cilën parashikohen detyrimet e ndërsjella, afatet e realizimit të projektit, vlera e projektit, ndalimet për tjetërsimin e pronësisë së strukturave të ndërtuara apo pjesëve të tyre, si dhe pasojat nga mosrespektimi i detyrimeve të ndërsjella.”.

Neni 3

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 9 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 1 të nenit 33/2.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2017

Shpallur me dekretin nr. 10705, datë 26.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



LIGJ
Nr. 115/2017

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË DIASPORËS

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton krijimin, misionin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Neni 2

Misioni

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për mision zhvillimin dhe konsolidimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet:

- a) përmirësimit të pozitës së diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të saj, aty ku gjendet;
- b) ofrimit të ndihmës për ruajtjen e gjuhës dhe trashëgimisë kulturore kombëtare;
- c) nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
- ç) bashkëpunimit për prosperitetin, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror të të gjithë kombit.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agjencia Kombëtare e Diasporës”, në vijim “Agjencia”, është organi shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën.

2. “Diaspora” përfshin:

- a) komunitetet e hershme shqiptare në botë;

b) çdo person i lindur në Shqipëri, që banon në mënyrë të përhershme jashtë kufijve të saj;

c) çdo person, me origjinë shqiptare, i lindur dhe që banon në mënyrë të përhershme jashtë kufijve të Shqipërisë.

3. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e veprimtarisë shtetërore për marrëdhëniet me diasporën.

4. “Vend i origjinës” është Republika e Shqipërisë.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë

Agjencia organizohet dhe funksionon në bazë të parimit të ligjshmërisë, kushtetutshmërisë, të bashkëpunimit dhe të gjithëpërfshirjes.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I
AGJENCISË

Neni 5

Organizimi i Agjencisë

1. Agjencia është person juridik publik, në formën e agjencisë autonome, me seli në Tiranë, në kuptimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

2. Veprimtaria e Agjencisë është nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për diasporën.

3. Organet drejtuese të Agjencisë janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.

4. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për diasporën.

5. Marrëdhëniet e punës për Drejtorin Ekzekutiv dhe nëpunësit e Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen sipas Kodit të Punës.

Neni 6

Detyrat e Agjencisë

Agjencia kryen këto detyra:

1. Merr masa për krijimin e bazës unike të të dhënave të diasporës, në bazë të vullnetit të lirë të personit. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.



2. Zbaton politika dhe projekte që lidhen me diasporën.

3. Përgatit raporte periodike për veprimtarinë e Agjencisë, të cilat ia paraqet për miratim ministrit përgjegjës për diasporën.

4. Përgatit dhe koordinon punën për hartimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe ndjek zbatimin e saj.

5. Mban lidhjet ndërmjet diasporës, përfaqësuesve të saj dhe vendit të origjinës.

6. Përgjigjet për funksionimin dhe menaxhimin financiar të Agjencisë.

7. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë.

8. Ndihmon në ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës, vlerave kombëtare dhe kulturore të diasporës.

9. Informon diasporën mbi proceset politike në vendin e origjinës, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë.

10. Administron asetet që ka në dispozicion.

Neni 7

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Agjencisë.

2. Këshilli Drejtues është organ kolegjal, i përbërë nga shtatë anëtarë, nga të cilët:

a) një përfaqësues nga ministri përgjegjës për diasporën;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme;

c) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e brendshme;

ç) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;

d) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

dh) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturën;

e) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për turizmin.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues është 4 vjet.

4. Ministri përgjegjës për diasporën emëron kryetar të Këshillit Drejtues njërin prej anëtarëve të tij.

5. Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregulla të hollësishme për emërimin, shkarkimin dhe shpërblimin e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Neni 8

Kompetencat e Këshillit Drejtues

Këshilli Drejtues ka këto kompetenca:

a) miraton programet e zhvillimit të Agjencisë, në përputhje me dokumentet strategjike për marrëdhëniet me diasporën;

b) miraton rregulloren për organizimin e brendshëm administrativ, funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave të brendshme e të stafit administrativ e mbështetës;

c) ushtron kompetencat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

ç) propozon strukturën, organikën dhe nivelin e pagave të punonjësve të Agjencisë;

d) miraton buxhetin, planin e veprimit, planin financiar, raportin vjetor dhe raporte të tjera të Agjencisë;

dh) merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Drejtori Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për administrimin dhe funksionimin e Agjencisë dhe e përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

Drejtori Ekzekutiv emërohet në detyrë nga ministri përgjegjës për diasporën, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil.

Drejtori Ekzekutiv raporton në Këshillin Drejtues për veprimtarinë e Agjencisë.

Neni 10

Burimet dhe mënyrat e financimit të Agjencisë

1. Burimet financiare të Agjencisë janë:

a) të ardhura pjesërisht nga buxheti i shtetit;

b) të ardhura nga projekte, donacione dhe burime të tjera të ligjshme.



2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji dhe veprimtarisë përkatëse, Agjencia mund të ftojë subjekte të tjera, vendase ose të huaja, për bashkëfinancim projektesh, të cilat do të kontribuojnë në mbajtjen dhe forcimin e lidhjes ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Kriteret, procedura për akordimin e fondeve për bashkëfinancim të projekteve dhe mënyra e raportimit për zbatimin e tyre janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

KREU III

KOMPETENCAT PËR MARRËDHËNIET NDËRMJET VENDIT TË ORIGJINËS DHE DIASPORËS

Neni 11

Politikat e vendit të origjinës për diasporën

Këshilli i Ministrave përcakton politikat e vendit të origjinës për diasporën, për t'u zbatuar nga ministri përgjegjës, Agjencia dhe autoritete të tjera shtetërore, në përputhje me fushën e tyre të veprimtarisë.

Neni 12

Ministri përgjegjës për diasporën

Ministri përgjegjës për diasporën mbikëqyr veprimtarinë e Agjencisë, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Neni 13

Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Autoritetet shtetërore bashkëpunojnë në mënyrë të ndërsjellë për të përmbushur detyrat e tyre në fushën e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës.

2. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet raportimeve të përbashkëta dhe koordinimit të aktiviteteve, sipas mënyrës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IV DISPOZITA TË TJERA

Neni 14

Strategjia Kombëtare për Diasporën

1. Strategjia Kombëtare për Diasporën ka për qëllim ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës, si dhe identifikon gjendjen aktuale të këtyre marrëdhënieve dhe veprimet që duhen ndërmarrë për zhvillimin e tyre.

2. Strategjia miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për diasporën.

3. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Diasporës për të rishikuar në mënyrë periodike dokumentin e strategjisë.

Neni 15

Vula dhe logo e Agjencisë

Agjencia ka vulën dhe logon e saj. Modeli i logos është sipas formatit të aneksit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 16

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 5, nenit 11, nenit 13, pika 2, dhe nenit 14, pika 2, të këtij ligji.

Ngarkohet Kryeministri për nxjerrjen e aktit nënligjor në zbatim të pikës 4, të nenit 5, të këtij ligji.

Aktet nënligjore të parashikuara në këtë nen nxirren brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 18.12.2017

Shpallur me dekretin nr. 10706, datë 26.12.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



ANEKS



AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax +355 4 24 27 004 Tel. +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë